



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

---

Numri i lëndës: 2019:143349  
Datë: 05.12.2023  
Numri i dokumentit: 05017960  
P.nr.3167/18

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari i vetëm gjykues Dibran Jusufi, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Sadete Kuqi Berisha, në çështjen penale kundër të pandehurit Rr.M., për shkak të veprës penale Mashtrimi nga neni 335 par. 4 të KPRK-së, duke vepruar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm me numër PP.II.4404/15 të datës 13.07.2018, duke vepruar sipas detyrës zyrtare dhe jashtë seance, me datën 05.12.2023, mori këtë:

A K T V E N D I M

- I. HEDHET poshtë aktakuza e Prokurorisë Themelore në Prishtinë me numër PP.II.4404/15 të datës 13.07.2018 dhe PUSHOHET procedura penale ndaj të pandehurit Rr.M., për shkak të veprës penale Mashtrimi nga neni 335 par. 4 të KPRK-së ngase tanimë kjo vepër penale është përfshirë në parashkrimin relativ të ndjekjes penale.
- II. E dëmtuara “.....” për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko civil.
- III. Shpenzimet e procedurës penale paguhen nga mjetet buxhetore të kësaj gjykate.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm me datë 27.07.2018 pranë kësaj gjykate ka dorëzuar aktakuzën me numër PP.II.4404/15 të datës 13.07.2018, kundër të pandehurit Rr.M., për shkak të veprës penale Mashtrimi nga neni 335 par. 4 të KPRK-së.

Gjyqtari i çështjes me këtë lëndë është ngarkuar me datë 11.10.2023, me ç'rast duke vepruar sipas detyrës ka bërë shikim dhe analizimin e shkresave të lëndës, me ç'rast ka gjetur se vepra penale për të cilën është akuzuar i pandehuri përfshirë në parashkrimin relativ të ndjekjes penale ngase vepra penale Mashtrimi nga neni 335 par. 4 të KPRK-së numër 04/L-082, është e dënueshme me gjobë ose me burgim prej 1 deri në pesë (5) vite me burgim ndërsa bazuar në nenin 106 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 të KPRK-së numër 04/L-082 sipas të cilit thuhet se *“ndjekja penale nuk mund të ndërmerret nëse kanë pesë (5) vjet nga kryerja e veprës penale të dënueshme me më shumë se tre (3) vjet burgim”*, ndërsa nga shkresat e lëndës rezulton se aktakuza është ngritur në këtë gjykatë me datë 13.07.2018, e që deri më tani kanë kaluar mbi 5 (pesë) vite ndërsa në anën tjetër rezulton se nuk është ndërmarrë asnjë veprim në drejtim të ndjekjes penale, gjykata erdhi në përfundim ndaj të pandehurit të lartcekur duhet të hedhet aktakuza dhe të pushohet procedura penale ngase vepra penale për të cilën është akuzuar i pandehuri tanimë është përfshirë në parashkrimin relativ të ndjekjes penale.

Gjykata sipas detyrës zyrtare dhe konform nenit 107 paragrafi 6 të KPRK-së ku është përcaktuar se *“Afatit i parashkrimit po ashtu ndërpritet kur kryesi para skadimit të afatit të parashkrimit kryen një vepër tjetër penale me peshë të njëjtë ose më të rëndë se sa vepra penale e mëparshme”*, me ç'rast nga të dhënat e gjykatës ka gjetur se i pandehuri gjatë kësaj kohe nuk ka kryer ndonjë vepër tjetër penale, si kusht për ndërprerjen e afatit të parashkrimit.

Nga të lartcekurat dhe në bazë të nenit 106 paragrafi 1, nën paragrafi 1.4 të KPRK-ës dhe nenit 357 paragrafi 1, nën paragrafi 1.3 të KPP-ës është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

Departamenti i Përgjithshëm

P.nr.3167/18, me datë 05.12.2023

Gjyqtari i vetëm gjykues,

Dibran Jusufi

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi, mund të ushtrohet ankesë në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë brenda afatit prej 3 (tri) ditëve nga dita e pranimit të aktvendimit, e nëpërmjet të kësaj Gjykate.